



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/  
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science*

# UDHËZUES

## ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE ME BAZË NË SHKOLLË

PRISHTINË, 2026

Ky udhëzues është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës / Këshillit Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve, zyrtarëve arsimorë në DKA, drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve të përfshirë në takimet konsultative rajonale për rishikimin e këtij udhëzuesi.

Udhëzuesi referencë kryesore e ka Udhëzimin administrativ (UA) 16/2023 për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve (ZHPM). Ky UA rregullon ZHPM në kuadër të sistemit të licencimit të mësimdhënësve, pasqyron rëndësinë e ZHPM me bazë në shkollë dhe vendos bazat për funksionimin e tij në nivel shkolle.

## **Përmbajtja**

Lista e shkurtesave.....	<a href="#">4</a>
1. Hyrje.....	<a href="#">5</a>
2. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve me bazë në shkollë në dritën e kuadrit të politikave të reja arsimore.....	<a href="#">7</a>
3. Institucionalizimi i Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve me Bazë në Shkollë.....	<a href="#">9</a>
4. Format e qëndrueshme të zhvillimit profesional me bazë në shkollë.....	<a href="#">12</a>
5. Modeli kolegial i sigurimit të cilësisë në Kosovë dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve me bazë në shkollë.....	<a href="#">15</a>
6. Procedurat e brendshme të zhvillimit profesional me bazë në shkollë.....	<a href="#">16</a>
7. Programet dhe aktivitetet e ZHPMBSH.....	<a href="#">22</a>
8. Procedurat e jashtme - përkrahja e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë.....	<a href="#">23</a>
9. Strukturat mbështetëse të zhvillimit profesional me bazë në shkollë.....	<a href="#">25</a>
10. Instrumente pune për realizimin e ZHPMBSH.....	<a href="#">30</a>
Modeli i strukturës për përcaktimin e prioriteteve për ZHPMBSH për 2-3 vite.....	<a href="#">31</a>
Modeli i strukturës së Planit vjetor të zhvillimit profesional me bazë në shkollë.....	<a href="#">32</a>
Modeli i strukturës së Planit Individual për Zhvillimin Profesional (ZHPM).....	<a href="#">33</a>
Modeli për planifikimin e sesioneve të punëtorisë/seminareve me bazë në shkollë.....	<a href="#">34</a>
Plani i hulumtimit në veprim (afatgjatë/bashkëpunues).....	<a href="#">35</a>
Modeli i strukturës së raportit përmbledhës nga trajnimet/ punëtoritë për ZHPMBSH.....	<a href="#">37</a>
Korniza e përmbajtjes për portofolion profesionale të ZHPMBSH.....	<a href="#">38</a>
Modeli i Certifikatës për ZHPMBSH.....	<a href="#">39</a>
Bibliografia.....	<a href="#">41</a>

## Lista e shkurtesave

<b>AP</b>	Aktivat Profesionale
<b>ESH</b>	Ekipi Shkollor
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>DZHPLPA</b>	Divizioni për Zhvillim Profesional dhe Licencimin e Personelit Arsimor
<b>IA</b>	Inspektorati i Arsimit
<b>IPK</b>	Instituti Pedagogjik i Kosovës
<b>KDSH</b>	Këshilli Drejtues i Shkollës
<b>KK</b>	Këshillat e Klasës
<b>KSZHMK</b>	Kornizë Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve e Kosovës
<b>KSHLM</b>	Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve
<b>MASH</b>	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik për Arsim në Kosovë
<b>PZHI</b>	Plani Zhvillimor Individual
<b>PZHS</b>	Plani i Zhvillimit të Shkollës
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>VPM</b>	Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve
<b>ZHP</b>	Zhvillim Profesional
<b>ZHPM</b>	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve
<b>ZHPMBSH</b>	Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve me Bazë në Shkollë
<b>ZHPV</b>	Zhvillimi Profesional i Vazhdueshëm

## 1. Hyrje

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), në vitet e fundit ka rishikuar kuadrin e politikave arsimore që lidhen me sistemin e licencimit të mësimit të mesimdhënësve. Në këtë rishikim, zhvillimi profesional me bazë në shkollë merr dimension të ri sa i përket organizimit të programeve dhe formave të zhvillimit profesional.

Zhvillimi Profesional i Mësimit të Mesimdhënësve me Bazë në Shkollë (ZHPMBSH) është vendosur si një nga mekanizmat kryesorë për ngritjen e cilësisë së mësimit të mesimdhënësve dhe për krijimin e një kulture profesionale bashkëpunuese brenda institucioneve arsimore, si një instrument i motivimit dhe mekanizëm për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe avancimin e kompetencave të mësimit të mesimdhënësve.

### 1.1. Qëllimi i udhëzuesit

Ky udhëzues është përgatitur duke marrë për bazë kuadrin e politikave të reja arsimore, programet dhe udhëzuesit që referojnë për rolin e shkollës, punën e mësimit të mesimdhënësve, zhvillimin profesional dhe karrierën në mësimit të mesimdhënësve dhe që vendosin bazat e ZHPMBSH.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ndihmojë palët e përfshira në ZHPMBSH, veçanërisht shkollat dhe DKA-të, në përmirësimin e të kuptuarit për rolet, mundësitë, procedurat dhe praktikën e realizimit të zhvillimit profesional me bazë në shkollë, në dritën e rregullimeve me Udhëzimin administrativ-16/2023 për Zhvillim Profesional të Mësimit të Mesimdhënësve (ZHPM).

Objektivat e udhëzuesit janë:

- të ndihmojë në ngritjen e informimit dhe të kuptuarit për rëndësinë e institucionalizimit të ZHPMBSH
- të promovojë format qëndrueshme të zhvillimit profesional me bazë në shkollë
- të ofrojë udhëzime dhe mjete praktike për shkollat dhe strukturat mbështetëse për realizimin e ZHPMBSH në mënyrë efektive.

Udhëzuesi shërben si një udhërrëfyes me ide për veprimet që duhet ndjekur në nivel shkollë për të zbatuar ZHPMBSH, duke iu përshtatur kontekstit, rrethanave, kapaciteteve dhe mundësive të shkollës. Udhëzuesi është referencë për qasjet që duhet të ndjekin shkollat për institucionalizimin e ZHPMBSH, zbatimin e të gjitha procedurave të brendshme për planifikimin dhe realizimin e ZHPMBSH, zbatimin e formave kreative dhe të qëndrueshme të ZHPMBSH, ndjekjen e procedurave dhe kritereve për certifikimin e mësimit të mesimdhënësve të përfshirë në ZHPMBSH, fuqizimin e strukturave mbështetëse në ZHPM me bazë në shkollë, etj.

Gjithashtu, udhëzuesi do të jetë një burim i rëndësishëm dhe praktik për DKA-të dhe MASH-i, që kanë rol mbështetës dhe mbikëqyrës për zbatimin e ZHPMBSH, për të ofruar mbështetjen dhe përkrahjen e nevojshme për shkollat, për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e aktiviteteve të ZHPMBSH.

## 1.2. Konteksti i zhvillimit profesional të mësimit të mesimdhënësve

Zhvillimi profesional i mësimit të mesimdhënësve (ZHPM) përbën një nga faktorët më të rëndësishëm për rritjen e cilësisë së arsimit dhe përmirësimin e rezultateve të nxënësve. Është kërkesë thelbësore e procesit të mësuarit të vazhdueshëm, përmirësimit dhe avancimit të performancës së shkollës. Kushtet e reja ndaj ZHPM vijnë në një kohë kur shkolla dhe proceset e mësimit të mesimdhënësve përballen me kërkesa dhe ndryshime në kurrikula, integrim të teknologjisë në mësimit të mesimdhënësve, kompetenca të reja dhe rritje të përgjegjësisë profesionale të mësimit të mesimdhënësve.

Hulumtimet e fundit theksojnë rëndësinë e profesionalizimit të ri të mësimit të mesimdhënësve, ku ata shihen si akterë aktivë në identifikimin dhe adresimin e nevojave për zhvillim profesional (Saqipi, 2014). Kjo kërkon decentralizim të proceseve, në mënyrë që aktivitetet të burojnë nga nevojat e vetë mësuesve dhe shkollës, e jo vetëm nga kërkesa të jashtme.

Përpjekjet e sistemit të arsimit në Kosovë për të fuqizuar komponenten e ZHPM në vitet e fundit lidhen ngushtë me reformën kurrikulare, e cila fuqizoi konceptin e zhvillimit me bazë në shkollë. Kurrikula e re parasheh përgjegjësi dhe autonomi të shtuar të shkollave që lidhen me zbatimin e kurrikulës, të cilat janë të ndërlidhura ngushtë edhe me nevojën për ngritjen e kapaciteteve të mësimit të mesimdhënësve.

Në linjë me reformën kurrikulare, MASH ka vite që ka përcaktuar fushë prioritare zhvillimin e vazhdueshëm profesional të gjithë punonjësve arsimorë, në mënyrë të veçantë zhvillimin profesional të mësimit të mesimdhënësve, me qëllim zhvillimin e kompetencave profesionale dhe përmbushjen e kërkesave të vendosura në sistemin e licencimit të mësimit të mesimdhënësve.

Në kuadër të kërkesave të reja për ZHPM, MASH përmes Udhëzimit administrativ (UA) 16/2023 për Zhvillim Profesional të Mësimit të mesimdhënësve (ZHPM), ka përcaktuar edhe modelet e zhvillimit profesional të mësimit të mesimdhënësve në Kosovë. Modeli i ZHPM përfshin:

- (i) ofrimin e programeve të trajnimit nga ofruesit e jashtëm, dhe
- (ii) ofrimin e zhvillimit profesional të mësimit të mesimdhënësve me bazë në shkollë (ZHPMBSH) përmes qasjes me bazë në shkollë.

Një sistem i institucionalizuar i ZHPMBSH udhëhiqet nga parimet e përcaktuara në UA 16/2023 për ZHPM. Ai është **i thjeshtë, lehtësisht i realizueshëm, fleksibil, bashkëpunues, efektiv dhe i qëndrueshëm**. Këto parime merren si pika referuese për institucionalizimin e ZHPMBSH rreth një sistemi procedurash dhe aktiviteteve që mund të jenë instrumente për përmirësim të praktikës aktuale të ZHPM.

## 2. Zhvillimi profesional i mësimit të mesimdhënësve me bazë në shkollë në dritën e kuadrit të politikave të reja arsimore

Zhvillimi profesional i mësimit të mesimdhënësve nuk është i izoluar ndaj zhvillimeve tjera në sistemin arsimor, përkundrazi është në funksion të ngritjes së kapaciteteve për zbatimin efektiv të kuadrit të politikave arsimore që lidhen me shkollën, kurrikulën, mësimit të mesimdhënësve dhe të nxënësve. ZHPMBSH ka referencë në disa dokumente dhe politika arsimore, të cilat lidhen me mësimit të mesimdhënësve, mësimit të mesimdhënësve dhe rolin e shkollës në përmbushjen e pritshmërive të përcaktuara nga shoqëria. Ato janë:

- *Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë*
- *Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar*
- *Korniza për Sigurimin e Cilësisë të Performancës së Shkollës*
- *Udhëzimet Administrative për Sistemin e Licencimit të Mësimdhënësve në Kosovë.*

### **2.1. Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë (KSZHMK)**

Është dokument dinamik i lidhur me zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë. Përcakton standardet e profesionit të mësimdhënësit përgjatë karrierës (para-shërbimit, faza hyrëse në profesion dhe zhvillimi në karrierë), zberthen kompetencat në faza të ndryshme të karrierës dhe fazat e zbatimit të sistemit të zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë (MASHTI, 2017).

#### **Kur shkolla e përdor dokumentin e KSZHMK në kuadër të ZHPMBSH?**

Në parim, shkolla i referohet këtij dokumenti gjatë përgatitjeve dhe planifikimeve të saj për:

- *Informim të mësimdhënësve për fushat e mësimdhënies, standardet dhe kompetencat e mësimdhënësve*
- *Identifikim të nevojave për ZHPM dhe përcaktim të fushave prioritare për ZHPM*
- *Përcaktim të programeve dhe aktiviteteve për ZHPMBSH*
- *Motivim të mësimdhënësve për angazhim, vetëreflektim dhe vetëdrejtim të ZHP.*

### **2.2. Korniza kurrikulare për arsimin parauniversitar (KKAP)**

Zbatimi i këtij dokumenti dhe dokumenteve tjera kurrikulare (Kurrikulave Bërthamë dhe Kurrikulave lëndore) është i lidhur me nevojën për zhvillim profesional të vazhdueshëm të mësimdhënësve. Parimet e vendosura në dokumentin e kornizës kurrikulare, përveç që janë referencë e zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulës, janë edhe referencë e punës së shkollës për ZHPMBSH.

#### **Kur shkolla iu referohet parimeve të KKAP, në raport me ZHPMBSH?**

Atëherë kur:

- *Udhëheq qasje gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat e procesit të ZHPMBSH, duke filluar nga analiza e nevojave, planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe certifikimi si dhe duke ofruar mundësi të barabarta, pa asnjë përjashtim për të gjithë mësimdhënësit.*
- *Vendos në fokus të ZHPMBSH të mësuarit profesional që i kontribuon rritjes së përkrahjes së nxënësve në arritjen e kompetencave të përcaktuara me kurrikulë.*
- *Siguron që të mësuarit profesional të mësimdhënësve në kuadër të ZHPM me bazë në shkollë, e zhvillon praktikën e mësimdhënies dhe nxënies së integruar.*
- *Ndërton profilin e saj të ZHPM mbi bazën e autonomisë së shkollë, kapaciteteve dhe mundësive.*
- *Merr përgjegjësi të sigurojë qëndrueshmëri të ZHPMBSH.*

### **2.3. Korniza për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës**

Me këtë dokument, MASHTI përcakton pritshmërinë themelore nga çdo shkollë që vepron në Republikën e Kosovës, përmes kriterëve të cilësisë dhe treguesve të performancës së shkollës. Këto standarde do të shërbejnë si referencë për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e performancës së shkollës, referencë për planifikimin zhvillimor të shkollës, por edhe referencë për proceset e planifikimit të ZHPMBSH.

### **Kur i referohet shkolla këtij dokumenti në raport me ZHPMBSH?**

Shkolla, këtij dokumenti i referohet gjatë analizës së gjendjes, vetëvlerësimit të performancës së shkollës për përmbushjen e rolit të saj, gjatë identifikimit dhe vlerësimit të nevojave për ZHPM. Në këto procese, shkolla vetes duhet ti jap përgjigje sa dhe si i përmbush kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës të lidhur me ZHPM.

#### **2.4. Udhëzimet administrative për sistemin e licencimit të mësimdhënësve në Kosovë**

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është pjesë integrale e sistemit të licencimit të mësimdhënësve në Kosovë, i cili është rishikuar në vitin 2023. Ky sistem është vendosur si:

- Mekanizëm për zhvillim të vazhdueshëm profesional
- Instrument i motivimit - lidhjes së nivelit të performancës me paga të mësimdhënësve;
- Instrument i llogaridhënies;

Në vitin 2023 është rishikuar pako e pesë Udhëzimeve administrative (UA) të këtij sistemi. Tri prej këtyre UA janë të lidhura me zhvillimin profesional të mësimdhënësve, përfshirë edhe zhvillimin me bazë në shkollë:

- Udhëzimi administrativ (UA) 14/2023 për sistemin e licencimit dhe karrierën e mësimdhënësve. <https://masht.rks-gov.net/alldocuments/udhezim-administrativ-mashti-nr-14-2023-per-sistemin-e-licencimit-dhe-karrieren-ne-mesimdhenie/>
- Udhëzimi administrativ 15/2023 për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve. <https://masht.rks-gov.net/alldocuments/udhezim-administrativ-mashti-nr-15-2023-per-vleresimin-e-performances-se-mesimdhenesve/>
- Udhëzimi administrativ (UA) nr. 16/2023 për zhvillim profesional të mësimdhënësve. <https://masht.rks-gov.net/alldocuments/udhezim-administrativ-mashti-nr-16-2023-per-zhvillimin-profesional-te-mesimdhenesve/>

**Udhëheqja e shkollës dhe bartësit e procesit të ZHPMBSH duhet të sigurohen që çdo veprim në kuadër të shkollës për ZHPMBSH, planifikohet dhe realizohet duke iu referuar përcaktimeve dhe rregullimeve të këtyre UA.**

### **3. Institucionalizimi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë**

Institucionalizimi i ZHPMBSH nënkupton kalimin nga kjo qasje sporadike, pra organizimi i trajnimeve të veçanta dhe të njëpasnjëshme, në një sistem të integruar, të qëndrueshëm dhe pjesë përbërëse e funksionimit të rregullt të shkollës që ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm profesional të mësimdhënësve dhe rrjedhimisht performancën e shkollës.

Institucionalizimi i ZHPMBSH nënkupton:

- integrimin e zhvillimit profesional në kulturën e shkollës;

- ndërlidhjen e tij me misionin dhe vizionin e shkollës;
- krijimin e strukturave të brendshme funksionale që sigurojnë vazhdimësi, dhe
- ndërtimin e mekanizmave të bashkëpunimit me DKA-në dhe MASH-i.

### **Kultura e bashkëpunimit si themel i institucionalizimit**

Strategjitë për zhvillimin e kulturës së bashkëpunimit përfshijnë:

- *Komunitetet profesionale të të nxënësve*: grupe të strukturuar ku mësimdhënësit ndajnë praktika, analizojnë të dhëna të suksesit të nxënësve dhe hartojnë zgjidhje të përbashkëta.
- *Mentorimi dhe mësimdhënia kolegjale*: ku kolegët realizojnë vëzhgime joformale të orës mësimore dhe u ofrojnë komente konstruktive mësimdhënësve se si mund ta përmirësojnë praktikën profesionale.
- *Reflektimi i përbashkët*: diskutime pas orëve ose pas aktiviteteve të ZHPM, për të nxjerrë mësim praktikë.
- *Ndërtimi i besimit profesional*: sigurimi që pjesëmarrja të mos shihet si kontroll, por si mundësi për zhvillim profesional.

### **Krijimi i strukturave të brendshme funksionale që sigurojnë institucionalizim të ZHPMBSH**

Institucionalizimi kërkon një udhëheqje të qartë dhe një ndarje të saktë të përgjegjësiave. Ndarja e detajuar e roleve dhe përgjegjësiave siguron që aktivitetet e zhvillimit profesional të planifikohen, zbatohen dhe monitorohen në mënyrë të strukturuar dhe efektive dhe po ashtu nxit përgjegjësinë, koordinimin dhe bashkëpunimin, ashtu që ZHPMBSH të mos mbetet vetëm një formalitet, por të integrohet në mënyrë të qëndrueshme në aktivitete e përditshme të shkollës.

### **Drejtorët, pedagogët apo koordinatorët e cilësisë dhe strukturat mbështetëse në nivel shkolle duhet të sigurohen që:**

- Të planifikojnë aktivitetet e ZHPMBSH në kalendarin vjetor të shkollës.
- Të veprojnë sipas procedurave të brendshme të ZHPMBSH, për të cilat pasqyrohen udhëzime praktike për secilin hap të procedurave në kapitullin e shtatë të këtij udhëzuesi.
- Të përzgjedhin programe nga lista e MASH/KSHLM dhe t'i përshtatin sipas nevojave të shkollës, duke respektuar të drejtat autoriale ose të bëjnë marrëveshje kontraktuale me ofruesin e programeve, siç parasheh UA 16/2023.
- Të krijojnë kushte logjistike (kohë, hapësira, dokumentim) për secilën formë.
- Të dokumentojnë çdo aktivitet përmes listës së prezencës, agjendës, protokolleve të mentorimit dhe raporteve të hulumtimit në veprim.

- Të sigurojnë që përqindja e orëve të ZHPMBSH të përmbushë kërkesat për licencim sipas UA Nr. 14/2023.
- Të veprojnë duke marrë për bazë parimet udhëheqëse për ZHPMBSH, dhe të sigurojnë që zhvillimi profesional bëhet kulturë e të mësuarit, shkon përtej kërkesave për të marrë vetëm certifikata me bazë shkollë.

**Më gjerësisht për krijimin e strukturave të brendshme funksionale, shih kapitullin e 9-të, pjesën për Strukturat mbështetëse të zhvillimit profesional të mësimit me bazë në shkollë**

#### **Mësimdhënësit duhet të angazhohen në mënyrë aktive duke:**

- Marrë pjesë në programet dhe punëtoritë e planifikuara.
- Praktikuar mentorimin dhe këshillimin kolegial.
- Ndjekur hulumtimin në veprim për përmirësimin e praktikës mësimore.
- Reflektuar mbi përvojat dhe ndarë gjetjet me kolegët.
- Përfshirë aktivitetet e ZHPMBSH në portofolin profesional për licencim.

**Rikujtojmë: ZHPMBSH nuk është vetëm një detyrim ligjor për licencim, por edhe një mekanizëm i fuqishëm për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe për ndërtimin e një kulture bashkëpunuese profesionale në shkollë.**

#### **Ndërlidhja e ZHPMBSH me planin për zhvillimin e shkollës (PZHSH)**

Në mënyrë që ZHPMBSH të mos mbetet komponentë formale, por të integrohet si pjesë organike e jetës së shkollës, nevojitet një planifikim i strukturuar dhe praktik. Kjo pjesë shpjegon se si mund të lidhet plani vjetor i ZHPMBSH me PZHSH dhe si mund të përkthehet në veprime konkrete dhe si të monitorohet në mënyrë të rregullt.

Prioritetet dhe plani vjetor i ZHPMBSH duhet të jetë pjesë përbërëse e planit zhvillimor të shkollës (PZHSH) dhe planit vjetor të punës së shkollës që të sigurohet se aktivitetet e zhvillimit profesional lidhen drejtpërdrejt me objektivat afatgjata të shkollës dhe prioritetet e shkollës, të artikuluar në planet e saj. Integrimi i planit realizohet përmes disa hapave të përshkruara në kapitullin e shtatë të këtij udhëzuesi: Procedurat e brendshme të zhvillimit profesional të mësimit me bazë në shkollë.

Ndërlidhja e ZHPMBSH me planin për zhvillimin e shkollës (PZHSH) bëhet përmes ciklit të përmirësimit të vazhdueshëm, siç reflektohet në figura 1.




Figura 1. Cikli Strategjik i ZHPMBSH

## Strategjitë e qëndrueshmërisë

Elemente kyçe për qëndrueshmërinë e ZHPMBSH për secilin nivel të sistemit arsimor:

- **Në nivelin e MASH:**
  - Integrimi i ZHPMBSH në kalendarin e vitit shkollor
  - Zhvillimi i platformave digjitale
- **Në nivelin e DKA-së:**
  - Krijimi i ekipit koordinues komunal për ZHPMBSH
  - Rrjetëzimi i shkollave
- **Në nivelin e shkollës:**
  - Integrimi në kalendarin – dinamikën e orarit të punës së mësimdhënësve
  - Mbështetja e mësimdhënësve me role koordinuese dhe organizative
  - Komunikimi i vazhdueshëm nga drejtori
  - Njohja dhe vlerësimi i sukseseve
  - Përfshirja e prindërve në planifikimin e ZHPM.

## 4. Format e qëndrueshme të zhvillimit profesional me bazë në shkollë

Sipas UA nr. 16/2023, format e ZHPMBSH janë si më poshtë:

- Programet/trajnime në nivel shkollë (nga lista e akredituar e MASH);
- Punëtoritë dhe seminarët e organizuara nga vetë shkolla;
- Këshillimi dhe mentorimi ndërmjet kolegëve;
- Huluntimi në veprim nga grupet e mësimdhënësve.

Zbatimi në praktikë i këtyre formave të zhvillimit profesional, lidhet me prioritetet e shkollës, fushat tematike dhe aktivitetet e zhvillimit profesional që shkolla i planifikon për ti realizuar. Për të lehtësuar zbatimin në praktik, *Tabela* më poshtë paraqet disa udhëzime dhe modalitete për shkollat.

*Tabela 1. Zbatimi praktik i katër formave të ZHPMBSH*

Format e ZHPMBSH	Udhëzime për shkollën	Modalitete praktike
<b>Programet/ trajnime në nivel shkollë</b>	Shkolla përzgjedh programet nga lista e MASH/KSHLM, i përshtat sipas nevojave të saj dhe i planifikon në kalendarin vjetor, duke siguruar kushtet logjistike dhe respektimin e të drejtave autoriale; çdo përshtatje bëhet vetëm brenda fleksibilitetit të lejuar, duke ruajtur burimin dhe autorësinë. Shkolla mund të bëj marrëveshje kontraktuale vet ose nga DKA me ofruesin e programit të trajnimit të përzgjedhur nga shkolla/t për nevojat e mësimdhënësve të saj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizimi i ditëve pedagogjike (ditë të plota të dedikuara për trajnime të stafit).</li> <li>- Programet semestrare sipas lëndëve (trajnim i vazhdueshëm për grupe mësuesish brenda fushës së tyre).</li> <li>- Partneritet me shkollën qendër (ose me shkollat e vogla që mund të bashkëngjiten në trajnimet e organizuara nga shkollat më të mëdha).</li> <li>- Kombinim on-site/online (pjesë e trajnimit në shkollë, pjesë online për fleksibilitet).</li> <li>- Trajnime në kaskadë (një grup i trajnuar përcjell njohuritë te kolegët e tjerë).</li> </ul>
<b>Punëtori dhe seminarë në shkollë</b>	Shkolla sigurohet që punëtoritë dhe seminarët të udhëhiqen nga mësimdhënës me kapacitete profesionale, përfshirë kryesues të aktiviteteve, mësimdhënës me kualifikim master dhe me përvojë në organizimin e seminarëve, si dhe ata me përvojë zhvillimore brenda dhe jashtë shkollës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizimi i sesione të shkurtra për zgjidhje konkrete 90-minutëshe.</li> <li>- Laboratori i mësimdhënies (një mësues demonstroi orën, të tjerët reflektojnë dhe diskutojnë).</li> <li>- Modeli “rrotacioni i nikoqirit” me shkolla fqinje (një shkollë organizon, tjetra pason, në mënyrë rrotulluese).</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Punëtori mes kolegëve apo koleg-me-koleg-mësuesi me përvojë udhëheq punëtorinë për kolegët.</li> </ul>
<b>Këshillimi dhe mentorimi ndërmjet kolegëve</b>	Caktimi i mentorëve nga mësime të mësuara nga përvojë; planifikimi i orarit fleksibil; monitorimi i procesit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i çifteve mentor-mentor ose triadave (mësuesi i ri lidhet me kolegët me përvojë ose kolegë të fushës së njëjtë)</li> <li>- Zhvillimi i të mësuarit në hapa (vëzhgime të shkurtra të orëve për mësim nga kolegët).</li> <li>- Mentorim ndërshkollor (kombinim i takimeve online dhe vizitave në shkolla tjera).</li> <li>- Mentorimi kolegial përmes ciklit të mentorimit (3-4 mësues takohen rregullisht për reflektim dhe mbështetje të ndërsjellë).</li> <li>- Triada ndër-disiplinore (mentorimi bëhet mes mësuesve të fushave të ndryshme).</li> </ul>
<b>Hulumtimi në veprim</b>	Nxitja e grupeve të vogla të hulumtimit; dedikimi i kohës dhe hapësirës; organizimi i shpërndarjes së gjetjeve.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mini hulumtime 8-javore në grupe (testim i një metode të re dhe reflektim mbi rezultatet).</li> <li>- Mësimi përmes praktikës (planifiko-vëzhgo-reflekto-ripërpuno) (analizë ciklike e një ore të përbashkët mësimore).</li> <li>- Grupe ndër-shkollore me prezantim komunal (shkollat e vogla bashkohen dhe ndajnë gjetjet në nivel të shkollave të tyre dhe në nivel komune).</li> <li>- Mini-projekte të integruara në planin mësimor (hulumtime të vogla që lidhen drejtpërdrejt me temat e lëndëve).</li> <li>- Partneritete me universitetet (bashkëpunim për mbështetje metodologjike dhe akademike).</li> </ul>

## Lidhja mes kërkesave të licencimit dhe formave të ZHPMBSH

Format e ZHPMBSH lidhen drejtpërdrejt me orët e zhvillimit profesional që njihen në sistemin e licencimit të mësimdhënësve. Shkollat duhet ta kenë parasysh se sipas UA nr. 14/2023 për ZHPM, një pjesë e konsiderueshme e orëve të kërkuara për avancim në karrierë duhet të realizohet me bazë në shkollë (ZHPMBSH):

- Licenca e Karrierës – nga 100 orët minimale të kërkuara, 50% duhet të jenë ZHPMBSH;
- Licenca e Avancuar – nga 200 orët minimale të kërkuara, 50% duhet të jenë ZHPMBSH;
- Licenca e Përhershme – nga 300 orët minimale të kërkuara, 70% duhet të jenë ZHPMBSH.

Për të siguruar se shkolla e përmbush rolin e saj për orët e ZHPMBSH, shkolla kujdeset të bëjë llogaritjen e orëve të zhvillimit profesional për secilën formë të ZHPMBSH, sipas shembujve në tabelën në vijim:

*Tabela 2. Skema orientuese e orëve sipas formave të ZHPMBSH*

Format e ZHPMBSH	Si llogariten orët për zhvillim profesional	Shembull praktik në vit	Orë të fituara në vit	Shënim praktik
<b>Programet/trajni me në nivel shkollë</b>	1 ditë = 6 orë (ose 2×3 orë)	2 ditë pedagogjike në vit	12 orë	Duhet të jenë nga programet e miratuara nga MASHTI dhe të përfshira në planin e ZHPMBSH
<b>Punëtori dhe seminare</b>	1 punëtori = 3 orë	3 punëtori në vit (p.sh. një në çdo tremujor)	9 orë	Duhet të jenë përfshira në planin e ZHPMBSH
<b>Këshillimi dhe mentorimi ndër kolegë</b>	1 seancë = 45 min ≈ 1 orë	10 seanca mentorimi në vit	10 orë	Duhet përfshirje në plan të ZHPMBSH, marrëveshje dhe protokoll mentorimi
<b>Hulumtimi në veprim</b>	1 projekt = 15–25 orë (sipas planit)	1 projekt 8-javor në vit	20 orë	Kërkon plan të miratuar dhe raportim me gjetje

Pra, të dhënat nga tabela 2 tregojnë se sa orë mund të gjenerohen nga secila prej katër formave të ZHPMBSH. Ajo shërben si një udhëzues praktik për udhëheqësit e shkollës dhe mësimdhënësit, sepse ofron një pasqyrë të thjeshtuar të vlerës së secilës formë në procesin e zhvillimit profesional.

**Në vëmendje:** Shkollat duhet të ofrojnë mundësi të ZHPM përtej numrit minimal të orëve të kërkuara sipas kornizës ligjore për nivelet e licencës përkatëse (Udhëzimi administrativ (UA) 14/2023). ZHPM është proces i vazhdueshëm, i bazuar në nevojat e mësimdhënësve dhe prioritetet e shoqërisë dhe duhet parë përtej kërkesave minimale të sistemit të licencimit.

## 5. Modeli kolegial i sigurimit të cilësisë në Kosovë dhe zhvillimi profesional i mësimit në bazë në shkollë

Modeli kolegial i sigurimit të cilësisë në Kosovë përshkruan se si shkollat dhe ekipi komunal mbledhin dëshmi për praktikën e mësimit dhe nxënies dhe i verifikojnë ato nga tri burime:

- Vëzhgime joformale/kolegiale të orëve mësimore;
- Pyetësorë/diskutime për mbledhjen e pikëpamjeve të mësimit dhe nxënies, prindërve, nxëniesve;
- Shqyrtim të dokumenteve dhe analiza të punimeve të nxëniesve.

dhe integrojnë gjetjet në zhvillimin profesional dhe në planifikimin e përmirësimit të shkollës, duke forcuar vendimmarrjen e bazuar në dëshmi.




Figura 2: Ndërlidhja e modelit kolegial të sigurimit të cilësisë në Kosovë dhe ZHPMBSH

Për zbatim të suksesshëm të modelit kolegial të sigurimit të cilësisë në Kosovë për qëllime të ZHPMBSH, shkolla duhet ti shfrytëzojë dokumentacionin dhe materialet pedagogjike të zhvilluara nga projekti KosEd, të publikuara në faqen zyrtare të KosEd: [Modeli Kolegial i Sigurimit të Cilësisë | KosEd](#)

## 6. Procedurat e brendshme të zhvillimit profesional me bazë në shkollë

Procesi i ZHPMBSH duhet të zhvillohet sipas procedurave të brendshme të ZHPMBSH, të cilat janë përvijuar në UA nr. 16/2023 për Zhvillim profesional të mësimitdhënësve. Respektimi i procedurave të brendshme, bëjnë të mundur që procesi të jetë gjithëpërfshirës, i barabartë dhe mundësues për të gjithë mësimitdhënësit, praktik dhe i lehtë për zbatim në nivel shkollë.

Janë gjithsej nëntë hapa të procedurave të brendshme të ZHPMBSH, të cilët lidhen njëri me tjetrin. Për secilin hap të procedurave që pasqyrohen në diagramin në vijim, janë dhënë udhëzime dhe orientime se si duhet të veproj shkolla, përkatësisht personat përgjegjës sipas hapave.




Figura 3: Diagrami i hapave të procedurave të brendshme të ZHPMBSH

Kur shkolla i zhvillon procedurat e brendshme të ZHPMBSH, duhet të fokusohet në disa aspekte të cilat listohen në pjesën në vijim, të organizuara sipas hapave.

### Hapi 1. Analiza e kontekstit të përgjithshëm të ZHPM në nivel shkollë

Kjo analizë duhet të fokusohet në:

- Fushën e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve – kujtoni raportin e vetëvlerësimit të shkollës për këtë fushë të cilësisë së performancës së shkollës;
- Përfshirjen e ZHPM në planin e zhvillimit të shkollës dhe planin vjetor të punës së shkollës;
- Përfshirjen e mësimitdhënësve në programe të trajnimit nga ofertues të jashtëm dhe në format e ZHPBSH;
- Mësimet nga ZHP dhe përvojat e zbatimit në praktikat e klasës;
- Sfidat dhe problemet kryesore me të cilat përballen mësimitdhënësit;
- Kapacitetet, resurset e brendshme të shkollës për ZHPM, etj.

## **Hapi 2. Informimi i mësimdhënësve për ZHPBSH**

Çështjet kryesore që duhet të jenë në fokus të informimit të mësimdhënësve përfshijnë:

- Rolin e ri të shkollës në fushën e zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
- Profilin e kompetencave/standardet e mësimdhënësve për faza të ndryshme të karrierës të zërthyerë në dokumentin Korniza për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë (MASHT, 2017);
- Llojet e licencës, kriteret e ZHP për lëshimin e licencës dhe për kriteret e ZHP për ruajtjen e licencës (UA, 14/2023 për sistemin e licencimit);
- Dallimet kryesore ndërmjet ZHP me programe nga ofertuesit e jashtëm dhe ZHP përmes qasjes zhvillimore me bazë në shkollë;
- Format e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë;
- Orët e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë;
- Identifikimin e nevojave për ZHPMBSH;
- Prioritetet e shkollës gjatë fazës përgatitore për zbatim;
- Procedurat e planifikimit, realizimit, vlerësimit dhe monitorimit të ZHPBSH.

## **Hapi 3. Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për ZHPMBSH**

Shkolla, çdo dy vite bën identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për ZHPMBSH. Në vitin kur realizohet ky hap, shkolla e cakton ekipin - personat përgjegjës të cilët hartojnë planin dinamik për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për ZHPMBSH dhe bëjnë përgatitjet që ti mbledhin të dhënat në dy periudha.

Gjatë periudhës janar-prill, personat përgjegjës të shkollës realizojnë vëzhgime dhe biseda me mësimdhënës për:

- Qëllime të identifikimit dhe vlerësimit të nevojave të mësimdhënësve për ZHPM;
- Biseda me mësimdhënës para dhe pas vëzhgimit – fokusi në aspektet e vëzhgimit në orë mësimore, përparësitë, sfidat në mësimdhënie dhe nevojat për ZHP.

Personat përgjegjës, gjatë periudhës maj – qershor, realizojnë:

- Intervista me mësimdhënës;
- Fokus grupe – diskutime të drejtuara me udhëheqës të aktivave profesionale;
- Pyetësorë me mostër apo me gjithë personelin e shkollës;
- Shqyrtimi i planeve individuale për ZHPM;
- Analizë të raportit/eve të vetëvlerësimit dhe vlerësimit nga inspektorati i arsimit për performancën e shkollës.

Në fund të muajit qershor, personat përgjegjës të ekipit të shkollës, përgatisin një raport përmbledhës për vlerësim të nevojave për ZHPMBSH me propozimin për prioritetet e ZHPMBSH për dy vitet e ardhshme. Raporti i dorëzohet drejtorit të shkollës.

#### **Hapi 4. Përcaktimi i prioriteteve për ZHPBSH**

Me propozim të drejtorit të shkollës, KDSH përcakton prioritetet për ZHPBSH për dy vitet e ardhshme. Për definimin e prioriteteve për ZHPMBSH, KDSH i merr për bazë edhe disa faktorë të tjerë, si:

- Prioritetet e shkollës (të theksuara në planin zhvillimor të shkollës);
- Prioritetet komunale në zhvillimin e arsimit në Komunë dhe të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve;
- Prioritetet e identifikuarra shtetërore (si reformimi i kurrikulës shkollore, përdorimi i teknologjisë në mësimitdhënie, arsimit gjithëpërfshirës, etj);
- Kapacitetet dhe resurset që i ka shkolla në dispozicion, qoftë si mjete vetjake, qoftë në formë të projekteve me partnerët bashkëpunues;
- Zhvillimet e reja në shkencën e edukimit, gjegjësisht avancimi i njohurive për mësimitdhënie cilësore.

Me rastin e përcaktimit të prioriteteve të ZHPMBSH, shkolla përcakton detyrimin që merr për të përkrahur zhvillimin profesional të mësimitdhënësve. Prioritetet e shkollës për zhvillim profesional të mësimitdhënësve, duhet të përmbajnë së paku tre nga komponentët vijues:

- Përkrahjen e nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore dhe në realizimin e potencialit të tyre;
- Adresimin e problemeve kryesore me të cilat përballen mësimitdhënësit në punën e tyre profesionale;
- Avancimin e njohurive të praktikës për mësimitdhënie në kontekstin e kurrikulës së re dhe të praktikave të mira në nivel shkolle dhe të programeve e literaturës vendore apo ndërkombëtare.

**Në vëmendje:** Prioritetet e ZHPMBSH të miratuara nga KDSH integrohen në planin zhvillimor të shkollës dhe në planin vjetor të punës së shkollës. Për prioritetet e përcaktuara, programet dhe aktivitetet prioritare të ZHPMBSH, shkolla analizon kapacitetet e brendshme, përfshirë identifikimit të mësimitdhënësve/stafit të shkollës për trajnerë dhe mentor të ZHPMBSH.

#### **Hapi 5. Planifikimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë**

Shkolla çdo vit shkolle e harton planin për ZHPMBSH. Planifikimi ndërlidhet me kalendarin e vitit shkolle – fokusi në kohën kur nxënësit janë në pushime. Planifikimi përfshin:

- Të dhënat për procesin e hartimit të planit, arsyeshmërinë dhe qëllimet e përgjithshme;
- Prioritetet për ZHPM dhe objektivat e zërthyera sipas prioriteteve;
- Aktivitetet kryesore vjetore sipas prioriteteve;
- Format se si do të realizohen programet dhe aktivitetet e ZHP;
- Përgjegjësit sipas prioriteteve dhe aktivitetëve gjegjëse;

- Plani dinamik dhe afatet kohore;
- Burimet e nevojshme (kapacitetet njerëzore, trajnerë, mentor, resurse materiale dhe financiare, pajisjet, etj.);
- Mjetet e verifikimit/dokumentimit për realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Treguesit e realizimit të prioriteteve të ZHPMBSH.

Shkolla, para fillimit të zbatimit të planit të ZHPMBSH-së, obligohet të njoftojë DKA-në dhe MASH-i përmes Sektorit të Inspektimit të Arsimit për kalendarin e datave për zbatimin e tij.

## **Hapi 6. Zbatimi i programeve dhe aktiviteteve të ZHPMBSH**

Shkolla ka autonomi dhe fleksibilitet në zbatimin e ZHPMBSH-së. Planin e saj mund ta zbatoj si shkollë e vetme – me resurse dhe kapacitete të brendshme, apo edhe në bashkëpunim me shkollat tjera dhe me mbështetje nga DKA. Rikujtojmë se format e ZHPMBSH-së të njohura edhe me UA 16/2023, janë:

- Programe të trajnimit në nivel shkolle;
- Punëtori dhe seminare të organizuara nga vet shkolla;
- Këshillim dhe mentorim ndërmjet kolegëve;
- Kërkim/hulumtim në veprim nga grupe të mësimdhënësve.

Sipas Joyce dhe Showers (2002) janë 4 komponente të trajnimit, të cilat duhet të jenë komponente referuese në kuadër të zbatimit të ZHPMBSH:

- Teoria (njohuri për diçka të re, zhvillimi i një shkathtësie);
- Demonstrimi (modelimi i shkathtësive - lehtësuesi tregon/demonstron si bëhet një veprim praktikë në punën me nxënës, në klasë, etj.);
- Praktika (mësimdhënësi i përfshirë në trajnim, aktivitete të ZHPMBSH praktikon shkathtësitë në klasën e tij/saj, zakonisht për një periudhë të rekomanduar prej 8-10 javësh); dhe,
- Këshillim profesional mes kolegëve (mësimdhënësi angazhohet në punën e vazhdueshme bashkëpunuese me kolegët për të planifikuar dhe zhvilluar orët e mësimin dhe materialet e nevojshme për të zbatuar trajnimin në mënyrë efektive).

## **Hapi 7. Monitorimi i brendshëm i aktiviteteve të ZHPMBSH-së**

Në baza të rregullta vjetore, duke përdorur instrumente të monitorimit të brendshëm, vetë shkolla (drejtori i shkollës, mentori për ZHPM apo i deleguari për ZHPM) bën monitorimin e ZHPMBSH, përmes:

- Vëzhgimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional;
- Pyetësorëve për mësimdhënësit e përfshirë në aktivitetet e ZHPBMSH;
- Takimeve të rregullta mujore ose dy mujore me mësimdhënësit;
- Shqyrtimit të dosjeve profesionale të mësimdhënësve që pasqyrojnë elementet e aktiviteteve të zhvillimit profesional dhe vlerësimin eventual të dosjeve;
- Konsultimit me aktivet profesionale dhe këshillat e klasave mbi ndikimin e aktiviteteve të ZHP në proceset mësimore dhe të mësuarit.

Monitorimi i brendshëm bëhet me qëllim që:

- Të sigurohet se aktivitetet e ZHPMBSH realizohen sipas planifikimit;
- Të vlerësohet cilësia dhe efektiviteti i ZHPMBSH;
- Të identifikohen praktikat e suksesshme dhe sfidat që kërkojnë përkrahje për tejkalimin e tyre;
- Të bëhen rishikimet e dinamikës së aktiviteteve, në rastet kur kjo është e nevojshme;
- Të sigurohet qëndrueshmëri e ZHPMBSH, etj.

## **Hapi 8. Dokumentimi dhe raportimi i aktiviteteve të ZHPMBSH-së**

Dokumentimi siguron ruajtjen e të dhënave mbi procesin e ZHPMBSH dhe lehtëson pasqyrimin e dëshmimeve për:

- Aktivitetet e realizuara;
- Pjesëmarrjen e mësimdhënësve në aktivitete;
- Përmbajtjen e programeve, punëtorive, seminareve dhe formave tjera të ZHPMBSH;
- Arritjen e rezultateve të pritura;
- Certifikimin e mësimdhënësve.

Shkolla duhet të kujdeset që të përgatisë:

- Raporte pas përfundimit të çdo programi të trajnimit dhe për aktivitetet tjera të përfunduara në kuadër të ZHPMBSH;
- Raporte vjetore për DKA dhe MASHTI;
- Raportin përmbledhës në nivel shkolle – për një vit;
- Dosje/portfolio të mësimdhënësve të krijuara nga vetë mësimdhënësit, si rezultat i aktiviteteve të ZHPMBSH, të cilat përfshijnë: plane mësimore, reflektime, vetëvlerësim, prezantime, fotografi, materiale të tjera të lidhura me aktivitetet e realizuara në kuadër të ZHPMBSH.

## Hapi 9. Certifikimi me bazë në shkollë

ZHPMBSH, është i veçantë për çdo shkollë, edhe në raport me certifikimin. Pavarësisht kësaj, secila shkollë dhe DKA, certifikimin e mësimdhënësve me bazë në shkollë obligohet ta bëjë në përputhje me kriteret e përcaktuara UA nr.16/2023 dhe me kriteret e programit/programeve të trajnimit gjegjëse që realizohen në nivel shkolle apo komune.

Dëshmitë e certifikimit janë:

- Plani vjetori i shkollës për ZHPMBSH;
- Lista e pjesëmarrjes në programe të trajnimit dhe aktivitete tjera të ZHPMBSH;
- Plani vjetori i shkollës për ZHPMBSH;
- Lista e pjesëmarrjes në cilëndo formë të ZHPMBSH;
- Raportet e vlerësimit të portfoliove/dosjeve profesionale;
- Certifikatat nga ZHPMBSH;
- Raporte të lidhura me ZHPMBSH.

Në kuadër të certifikimit me bazë në shkollë, sipas UA nr.16/2023, certifikatat mund të lëshohen nga DKA dhe drejtori i shkollës, si dhe nga Drejtori i shkollës dhe Mentori i ZHPMBSH:

- **Certifikata e lëshuar nga DKA dhe drejtori i shkollës** – bëhet në rastet kur programi ofrohet nga DKA si pjesë e zhvillimit profesional me bazë në shkollë, në nivel komune; dhe
- **Certifikata e lëshuar nga drejtori i shkollës dhe mentori i ZHPMBSH** – bëhet në rastet kur programi/aktiviteti ofrohet nga vetë shkolla, si pjesë e zhvillimit profesional me bazë në shkollë, sipas procedurave të brendshme për ZHPM.

Dëshmitë e realizimit të ZHPMBSH janë të rëndësishme për certifikim, ato duhet të ruhen në nivel shkolle, sepse mund të jenë objekt i shqyrtimit dhe i verifikimit nga shkolla – komisioni i themeluar nga KDSH, nga DKA, MASH dhe Inspektorati i arsimit.

## 7. Programet dhe aktivitetet e ZHPMBSH

Për qëllime të ZHPMBSH, shkolla ka të drejtë të hartojë vet programe të trajnimit, të cilat i mban në formë të ditëve të trajnimit, seminareve dhe punëtorive, për fusha tematike me interes për mësimdhënësit e saj. Programet e zhvilluara nga shkolla për nevojat e brendshme nuk ka nevojë të kalojnë në procedura të miratimit nga MASH.

Parakushtet elementare për të ofruar programe të trajnimit dhe aktivitete të ZHPMBSH që kërkohen nga një shkollë janë përkushtimi, angazhimi dhe kapacitetet me:

- ❖ Trajnerë dhe mentorë të certifikuar në programe të ndryshme trajnuese.
- ❖ Mësimdhënës me performancë të lartë dhe me studime të nivelit Master në programet që ndërlidhen me gjithëpërfshirjen, kurrikulat, mësimdhënien, udhëheqjen arsimore.
- ❖ Mësimdhënës me specializime të veçanta në fushat që lidhen me nevojat për ZHPM.

Siç është përshkruar në kapitullin për procedurat e brendshme të ZHPMBSH, prioritetet për programet e trajnimit dhe aktivitetet e ZHPM me bazë në shkollë, miratohen në nivel shkolle nga KDSH me propozim të drejtorit të shkollës ose kryetarit të aktivitetit profesional.

Për strukturim të programeve të trajnimit me bazë në shkollë, shkolla mund të përdorë strukturën e programeve të trajnimit të cilat janë miratuar/akredituar nga KSHLM, të cilat janë publikuara nga MASHTI në Katalogun e programeve të trajnimit. Struktura standarde duhet të përfshijë:

- të dhëna të përgjithshme për shkollën
- të dhëna të përgjithshme për programin - titulli i programit, kohëzgjatja, grupi i synuar
- të dhëna për trajnerët e programit
- përvoja e zhvillimit të programit – si është zhvilluar programi, si është përzgjedhur për ZHPMBSH
- qëllimet e programit dhe rezultatet e programit pas përfundimit
- përmbajtja e programit dhe aktivitetet: tema/t, qëllimi / rezultatet e pritura, aktivitetet, orët
- materiali i trajnimit
- metodologjia - *metodat interaktive dhe bashkëpunuese*
- sigurimi i cilësisë
- certifikimi.

Për qëllime të ZHPMBSH-së, shkolla mund t'i përdor programet aprovuara/miratuara nga MASH, programet që lidhen me prioritetet e shkollës. Përdorimi i këtyre programeve bëhet:

- me leje nga institucioni/organizata pronare e programit;
- me kontraktim nga shkolla dhe/apo nga DKA;
- nëse është e lejuar përdorimi i tyre sipas katalogut të programeve të trajnimit të publikuar nga MASH.

## 8. Procedurat e jashtme - përkrahja e zhvillimit profesional të mësimit në bazë në shkollë

Qasja e zhvillimit profesional me bazë në shkollë është relativisht e re për shkollat dhe sistemin e zhvillimit të mësimit në Kosovë, prandaj është e domosdoshme që të ndiqen disa procedura të jashtme të monitorimit, në funksion të përkrahjes së ZHPMBSH. Në kuadër të procedurave të jashtme, përfshihen:




Figura 4: Procedurat e jashtme - përkrahja e zhvillimit profesional të mësimit në bazë në shkollë

### (i) Monitorimi

Monitorimi i ZHPMBSH realizohet në periudha të caktuara:

- në baza të rregullta të monitorimit të shkollës dhe të ZHPMBSH-së,
- sipas nevojës – specifikave të programeve të trajnimit dhe specifikave të shkollave,
- në bazë të kërkesës së drejtorit të shkollës apo DKA.

Monitorimi i ZHPMBSH-së organizohet nga: MASH - zyrtarët e DZHPLPA dhe inspektorët e arsimit/SIA; DKA - zyrtari arsimor përgjegjës i caktuar për ZHPM / mentori për ZHPM në nivel të komunës/, apo një agjencion i kontraktuar për këtë qëllim) dhe ofruesit e programit të trajnimit.

Monitorimet përfshijnë :

- a) Planet e shkollave për ZHPBSH;
- b) Aktivitetet përgatitore rreth realizimit të seancave të zhvillimit profesional;
- c) Realizimin e seancave të zhvillimit profesional – punëtorive trajnuese, praktikave të mentorimit;
- d) Dosjet profesionale të mësimit në bazë, ku reflektohen aktivitetet e ZHPMBSH-së;
- e) Vëzhgime të një mostre të mësimit në bazë të përfshirë në kuadër të aktiviteteve dhe programeve të ZHPMBSH-së, për qëllim të mbledhjes së të dhënave për ndikimin e zhvillimit profesional në praktikën profesionale të mësimit në bazë.

## **(ii) Verifikimi**

Verifikimi i ZHPMBSH ka për qëllim të vërtetojë realizimin e aktiviteteve të ZHPMBSH, përmbushjen e kriterëve për realizimin e aktiviteteve të ZHPMBSH dhe kriterëve për certifikimin e mësimitdhënësve për ZHPBSH. Verifikimi është një hallkë lidhëse në mes të niveleve e strukturave të ndryshme të zhvillimit profesional në shkollë me ato jashtë shkollës dhe portë hyrëse për në procedurat e licencimit të mësimitdhënësve.

Raportet e shkollave për realizimin e ZHPMBSH, dosjet e mësimitdhënësve për ZHPM, dëshmitë e certifikimit të mësimitdhënësve për ZHPMBSH, raportet e monitorimit të brendshëm dhe të jashtëm të ZHPMBSH, konsiderohen mjetet kryesore që e ushqejnë procesin e verifikimit të ZHPBSH.

## **(iii) Certifikimi**

Certifikimi i jashtëm për ZHPMBSH bëhet vetëm për programe të akredituara nga MASH/ miratuara nga KSHLM të cilat ofrohen nga ofruesit e jashtëm të akredituar, që janë bartës të programeve gjegjëse të përzgjedhura dhe të kontraktuara nga shkolla ose DKA. Certifikimi bëhet sipas kriterëve të përcaktuara me miratimin e programeve gjegjëse nga MASH/KSHLM.

## **(iv) Vlerësimi**

Vlerësimi dallon nga monitorimi i ZHPMBSH, për faktin se vlerëson gjithë procesin e ZHPMBSH, përfshirë:

- a) Efektivitetin dhe efikasitetin e qasjes me bazë në shkollë sipas komunave, rajoneve apo shkollave;
- b) Ndikimin e ZHPBSH në përmirësimin e mësimitdhënies dhe në arritjet e nxënësve;
- c) Qëndrueshmërinë e qasjes së ZHPBSH;
- d) Relevancën e aktiviteteve të ZHPBSH për reformën dhe politikën arsimore.


Vlerësimi i këtyre aspekteve mbështetet në:

- Shqyrtimin e planeve të shkollës për zhvillim profesional dhe planet e tjera zhvillimore;
- Raporte të rregullta të punës të akterëve të përfshirë në procesin e ZHPBSH;
- Raportet e monitorimit;
- Dëshmitë e fituara përmes instrumenteve të vlerësimit dhe vetëvlerësimit;
- Portfolët profesionalë të mësimitdhënësve, etj.;
- Reflektime dhe opinione të mësimitdhënësve dhe akterëve tjerë të dhëna përmes instrumenteve të ndryshme (anketimit, intervistës, grupeve të fokusit, etj.).

## 9. Strukturat mbështetëse zhvillim profesional me bazë në shkollë

Strukturat mbështetëse për ZHPMBSH, bazohen në kapacitetet dhe burimet në dispozicion të institucioneve që kanë role dhe përgjegjësi në ZHPMBSH. Ato përbëhen nga strukturat mbështetëse:

- në nivel shkolle;
- në nivel komune – Drejtoria Komunale për Arsim (DKA); dhe
- në nivel qendror - MASH.



**Figura 5:** Diagrami i lidhjes së institucioneve arsimore dhe strukturave të tyre mbështetëse për ZHPMBSH

### 9.1. Strukturat mbështetëse në nivel shkolle për ZHPMBSH


Strukturat mbështetëse në nivel shkolle formohen dhe aktivizohen brenda një mandati të caktuar për të planifikuar dhe zbatuar qasjen e ZHPMBSH. Këto struktura punojnë ngushtë me akterët kyç të shkollës, si:

- Drejtori i shkollës
- Këshilli drejtues i shkollës (KDSH)
- Koordinator i cilësisë
- Shërbimi pedagogjik - psikologjik në shkollë
- Këshilli i mësimdhënësve dhe këshillat e klasës (KK)
- Aktivitetet profesionale dhe mësimdhënësit individual.

Një pjesë e këtyre akterëve kyç të shkollës, duhet të jenë pjesë e strukturave mbështetëse në nivel shkolle.

Siç kërkohet me UA 16/2023 për ZHPM, strukturat mbështetëse në nivel shkolle, përfshijnë:

Ekipin e shkollës (ESH) për ZHPMBSH, mentorin për ZHPMBSH i cili koordinon punën e ESH, koordinatorët për aktivitetet kryesore të ZHPMBSH, si dhe ekipin e trajnerëve dhe mentorëve me bazë në shkollë. Kjo përbërje reflektohet në figura 6.



*Figura 6: Ekipi i shkollës apo grup të shkollave për ZHPMBSH*

Themelimi i ESH për ZHPMBSH bëhet me një vendim të KDSH, përmes procesit konsultativ me drejtorin e shkollës dhe këshillin e mësimitdhënësve. Struktura e ESH për ZHPMBSH duhet të jetë fleksibile për të mundësuar adresimin e specifikave të shkollave individuale (të vogla / të mëdha; të mesme / fillore; përgjithshme / profesionale; etj). Mandati i ekipit përcaktohet për dy vite, me mundësi vazhdimi dhe rishikimi.

Një strukturë e mundshme e ESH përbëhet nga pedagogu i shkollës (nëse shkolla e ka një të tillë) ose zëvendësdrejtori i shkollës, koordinatori i cilësisë (nëse shkolla e ka një të tillë), 3 - 5 mësimitdhënës udhëheqës të AP, mësimitdhënës me kualifikim master, mësimitdhënës të dalluar, trajnerë të certifikuar dhe më përvojë në organizimin e aktiviteteve të ZHPM.

Përbërja e ekipit shkollor është fleksibile, duhet të reflektojë në vete strukturat funksionale të aktiveve profesionale si dhe organizimin e mësimitdhënësve në aktiva profesionale. Në rastet e shkollave që konsiderohen të mëdha, psh. rreth 80 - 100 mësimitdhënës, mund të organizohet ekip shkollor i përbërë deri në 7 anëtarë, shkollat e vogla 3-5 anëtarë. Organet vendimmarrëse të shkollës vendosin për numrin e anëtarëve të ESH për ZHPMBSH.

Në rastet e shkollave të vogla, ESH për ZHPMBSH mund të organizohet edhe në bashkëpunim me një – dy shkolla të tjera që janë në afërsi, kanë partneritete dhe orientime të përbashkëta për zhvillimin e shkollave. Në rastet e tilla, planifikimi dhe realizimi i programeve dhe aktiviteteve të ZHPMBSH duhet të bëhet bashkërisht.

**Çdo formë e organizimit të ESH për ZHPMBSH duhet të marrë në konsideratë funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e ZHPMBSH, dhe duhet të marrë miratimin formal nga KDSH.**

**Mentori i ZHPMBSH** zgjidhet nga anëtarët e ESH për ZHPBSH. Mentori i ZHPMBSH është një urë në mes të ekipit të ZHPBSH dhe drejtorit të shkollës në njërën anë, mësimdhënësve dhe ekipit të ZHPBSH nga ana tjetër. Mentori për ZHPMBSH mund të zgjidhet pedagogu i shkollës, koordinatori i cilësisë, ose mund të zgjidhet një mësimdhënës në bazë të disa kriterëve, të cilat sigurojnë parakushte elementare për përmbushjen e rolit dhe detyrave të tij/saj.

Kriteret për përzgjedhje të mësimdhënësve në këtë pozitë janë:

- Mësimdhënës i certifikuar për trajner dhe mentor, që ka referencë afirmative për të ushtruar këtë rol;
- Mësimdhënës i dalluar dhe i përkushtuar për të mbështetur kolegët;
- Mësimdhënës që ka shkathtësi komunikuese dhe shkathtësi për punë në ekip;
- Mësimdhënës që ka qëndrime pozitive ndaj ndryshimeve arsimore dhe zhvillimeve në shkollë.

**Koordinatorët për programe dhe aktivitete të ZHPMBSH** përzgjidhen në varësi të numrit të programeve dhe aktiviteteve kryesore vjetore për ZHPMBSH. Mund të jenë anëtarë nga ESH për ZHPMBSH, mësimdhënës udhëheqës ta aktivave profesionale, etj.

**Trajnerë dhe mentorë të programeve dhe aktiviteteve të ZHPMBSH** përzgjidhen mësimdhënës trajnerë të certifikuar në fushat e ZHPM që janë pjesë e planit të ZHPMBSH, mësimdhënës më përvojë në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të ZHPM dhe mentorim të mësimdhënësve, mësimdhënës me kualifikim master dhe mësimdhënës të dalluar në fushat gjegjëse të cilat janë pjesë e prioritetëve të shkollës.

### **Roli dhe përgjegjësitë e strukturave mbështetëse për ZHPM në nivel shkolle**

Sipas rolit që kanë strukturat mbështetëse në nivel shkolle, mund të kenë përgjegjësitë në vijim:

Tabela 3: *Strukturat mbështetëse në nivel shkolle dhe përgjegjësitë kryesore*

Strukturat mbështetëse në nivel shkolle	Përgjegjësitë kryesore
<b>Ekipi shkollor për ZHPMBSH</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ I propozon drejtorit të shkollës mentorin për ZHPMBSH, koordinatorët, trajnerët dhe mentorët për programet dhe aktivitetet e ZHPMBSH, në varësi të numrit të aktiviteteve të ZHPM</li> <li>▪ Nën udhëheqjen e mentorit për ZHPMBSH harton planin vjetor të shkollës për ZHPMBSH</li> <li>▪ Ndan rolet dhe përgjegjësitë e secilit anëtarë të ESH për ZHPMBSH</li> <li>▪ Kujdeset në realizimin e të gjithë hapave të procedurave të brendshme për ZHPMBSH</li> <li>▪ Ndhmon mësimdhënësit në përgatitjen e dëshmimeve për verifikim certifikim dhe licencim</li> </ul>

**Mentori i  
ZHPMBSH**

- Së bashku me drejtorin e shkollës koordinon hartimin e planit vjetor të ZHPMBSH.
- Udhëheqë koordinimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me procedurat e brendshme të ZHPMBSH
- Koordinon punën me strukturat mbështetëse në nivel shkolle
- Monitoron rregullisht zbatimin e aktiviteteve.
- Harton raportet përmbledhëse dhe raportin vjetor
- Dokumenton punën për ZHPMBSH

**Koordinatorët  
e programeve  
dhe  
aktiviteteve të  
ZHPMBSH**

- Hartojnë kalendarin sipas aktiviteteve të ZHPMBSH për të cilat janë përgjegjës
- Sigurojnë hapësira, burimet dhe materialet për aktivitetet gjegjëse të ZHPMBSH
- Koordinojnë aktivitetet dhe bashkëpunimin me trajnerët dhe mentorët e ZHPMBSH
- Monitorojnë rregullisht zbatimin e aktiviteteve që janë përgjegjës.
- Hartojnë raporte informuese dhe përmbledhëse për aktivitetet që i koordinojnë

**Trajnerë të  
ZHPMBSH**

- Hartojnë planet dhe programet për trajnimet, seminarët, punëtoritë që janë caktuar përgjegjës
- Informojnë mësimmshënësit dhe stafit për planin e aktiviteteve të trajnimit që janë përgjegjës
- Organizojnë trajnimet, seminarët, punëtoritë që janë përgjegjës
- Mbajnë evidence dhe listat e pjesëmarrjes për mësimmshënësit e përfshirë në aktivitetet e tyre
- Hartojnë raporte informuese dhe përmbledhëse për aktivitetet që janë përgjegjës

**Mentorë të  
ZHPMBSH**

- Ofrojnë mbështetje dhe mentorim individual për mësimmshënës
- Vëzhgojnë orë mësimore dhe ofrojnë informata kthyesë për mësimmshënësit e vëzhguar
- Modelojnë dhe prezantojnë praktika të mira
- Mbështesin mësimmshënësit në hartimin e planeve individuale për zhvillim profesional
- Ofrojnë këshillim dhe mbështetje sipas kërkesave të mësimmshënësve
- Mbajnë evidence për mësimmshënësit e mentoruar dhe hartojnë raporte informuese dhe përmbledhëse për mentorimin e realizuar.

Sa i përket përgjegjësi kryesore të strukturave mbështetëse në nivel shkolle për ZHPMBSH, udhëheqja e shkollës duhet të sigurohet që në vendimet për çdo strukturë në nivel shkolle të përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë për ZHPMBSH, afatet kohore të angazhimit dhe forma e raportimit. Ato mund të ndryshojnë nga shkolla në shkollë, në varësi të specifikave të organizimit dhe punës së shkollës.

## 9.2. Strukturat mbështetëse në nivel komunal

Roli i Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) në ndihmë shkollave për funksionalizimin e strukturave mbështetëse në nivel shkolle dhe praktikave efektive për ZHPMBSH është vendimtar.

Autoritetet arsimore komunale /DKA-të duhet të sigurojnë një mjedis i cili u mundëson të gjitha shkollave realizimin e qëllimeve të ZHPBSH. Në anën tjetër, shkollat duhet t'i përgjigjen bashkëpunimit me DKA, iniciativave të DKA-së për zhvillim profesional, të kërkojnë mbështetje nga DKA kur është e nevojshme, si dhe të promovojnë punën e tyre ZHPMBSH në aktivitetet vjetore që organizohen nga DKA.

Pavarësisht numrit të zyrtarëve arsimorë që ka një komunë, duhet të caktojë njërin prej udhëheqësve apo zyrtarëve arsimorë me rol mentor/koordinatorë që ka përgjegjësi ZHPM në nivel komune.

Pjesë e strukturave mbështetëse për ZHPMBSH nga niveli komunal/DKA, janë:

- **Mentori/koordinatori komunal për zhvillim profesional të mësimit të mesëm.** Këtë rol e ushtron njëri prej udhëheqësve apo zyrtarëve arsimorë në DKA me kualifikim dhe përvojë të lidhur me ZHPM. Mandati, kohëzgjatja (2-3 vite) dhe detyrat e mentorit/koordinatorit përcaktohen me vendimin e themelimit.
- **Ekipi komunal për zhvillimin profesional të mësimit të mesëm** - një ekip ekspertësh/trajnerësh, drejtorë të shkollave, pedagog dhe mësimit të mesëm shkollash, të cilët emërohen nga DKA-ja për të punuar me shkollat për ZHPM, nën udhëheqjen e mentorit/koordinatorit komunal për ZHPM. Mandati, kohëzgjatja (2-3 vite) dhe detyrat e ekipit përcaktohen me vendimin e themelimit.

## 9.3. Strukturat mbështetëse në nivel qendror

Strukturat mbështetëse në nivel qendror janë: MASH, Inspektorati i Arsimit, Instituti Pedagogjik i Kosovës, Fakultetet e Edukimit që përgatisin mësimit të mesëm të ardhshëm. Sa i përket këtyre strukturave mbështetëse në nivel qendror për ZHPBSH, është shumë e rëndësishme që udhëheqja e shkollës:

të njohë këto struktura, të vendosë kontaktet e bashkëpunimit, të iniciojë komunikimin dhe bashkëpunimin për mundësitë dhe nevojat e mbështetjes, por edhe për promovimin e punës së saj në ngjarje të rëndësishme për ZHPMBSH.

## 10. Instrumente pune për realizimin e ZHPMBSH

Instrumentet/formularët e punës për realizimin e ZHPMBSH janë mjete ndihmëse për shkollat, të cilat përdoren gjatë përgatitjes, planifikimit, organizimit, realizimit dhe monitorimit të ZHPMBSH. Në udhëzuesin e zgjeruar për ZHPMBSH, në ndihmë shkollave, janë zhvilluar gjithsej 21 instrumente/formularë pune.

Në këtë përmbledhje të udhëzuesit janë vendosur tetë (8) instrumente/formularë të domosdoshëm për realizimin e ZHPMBSH:

1. Modeli i strukturës për përcaktimin e prioriteteve për ZHPMBSH për 2-3 vite;
2. Modeli i strukturës së planit vjetor të zhvillimit profesional me bazë në shkollë;
3. Modeli i strukturës së planit individual për zhvillimin profesional (ZHPM);
4. Modeli për planifikimin e sesioneve të punëtorisë/seminareve me bazë në shkollë;
5. Plani i hulumtimit në veprim (afatgjatë/bashkëpunues);
6. Model i strukturës së raportit përmbledhës nga trajnimet/ punëtoritë për ZHPMBSH;
7. Korniza e përmbajtjes për portofolion profesionale të ZHPMBSH;
8. Modeli i certifikatës për ZHPMBSH.

Instrumentet e punës për shkollat, për realizimin e ZHPMBSH do të publikohen nga MASH në fazën zyrtare të divizionit për zhvillimin profesional dhe licencimin e personelit arsimor <https://masht.rks-gov.net/divizionit-per-zhvillimin-profesional-dhe-licencimin-epersonelit-arsimor/>

Instrumentet e punës për shkollat për qëllimet e ZHPMBSH, janë instrumente dinamike, mund të rishikohet dhe përditësohet bazuar në kontekstin e shkollave, në raport me numrin e mësimdhënësve dhe evidencat/dëshmitë që shkollat kanë për ZHPM.

## Modeli i strukturës për përcaktimin e prioriteteve për ZHPMBSH për 2-3 vite

### Të dhënat e përgjithshme

Shkolla: \_\_\_\_\_

Drejtori: \_\_\_\_\_

Data e mbledhjes së KDSH: \_\_\_\_\_

Periodha e planifikimit: \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_

Të dhënat për procesin e burimeve të përdorura për përcaktimin e prioriteteve për ZHPMBSH:

Prioritetet e shkollës: \_\_\_\_\_

Prioritetet komunale: \_\_\_\_\_

Prioritetet shtetërore: \_\_\_\_\_

Kapacitetet dhe resurset e shkollës: \_\_\_\_\_

Zhvillimet e reja në edukim: \_\_\_\_\_

### 1. Prioritetet e shkollës për ZHPMBSH (dy vitet e ardhshme)

Nr.	Prioriteti i përcaktuar	Përshkrimi i shkurtër (Bazuar në rezultatet e pyetësorëve të nevojave, vëzhgimeve dhe diskutimeve)	Komponentët e mbështetjes <sup>1</sup>	Përgjegjësi	Afati kohor
1					
2					
3					

### 4. Nënshkrimet

Drejtori i shkollës: \_\_\_\_\_

Kryetari i KDSH: \_\_\_\_\_

Anëtarët e KDSH: \_\_\_\_\_

<sup>1</sup> (i) Përkrahja e nxënësve në kompetencat kyçe; (ii) Adresimi i problemeve kryesore të mësimdhënësve; (ii) Avancimi i praktikave sipas kurrikulës së re.

## Model i strukturës së planit vjetor të zhvillimit profesional me bazë në shkollë

### Të dhënat e përgjithshme

Shkolla:

Komuna:

Viti shkollor:

Data e hartimit:

Hartuar nga:

Miraturar nga:

Të dhënat për procesin e hartimit të planit vjetor, arsyeshmërinë ( në ndërlidhje me prioritetet e PZSHH/ psh. "Rritja e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie" dhe prioritetet e shkollës për ZHPMBSH/ psh. Trajnim bazik për shfrytëzimin e teknologjisë në klasë) dhe qëllimet e përgjithshme

---



---



---

### Prioritetet vjetore për ZHPM dhe objektivat e zërthyer sipas prioriteve

Prioritetet vjetore	Objektivat e zërthyer sipas prioriteve	Lidhja me Prioritetin e Shkollës (nga PZSHH)	Indikatori i Suksesit (Rezultati i matshëm)	Aktivitetet kryesore sipas prioriteve vjetore	Forma/t e realizimit	Përgjegjësi (Fasilituesi)	Afati kohor
1							
2							
3							

### Plani i veprimit – aktivitetet vjetore sipas prioriteve

Aktivitetet vjetore sipas prioriteve	Format e realizimit të aktiviteve	Personat përgjegjës	Afatet kohore												Burimet e nevojshme (njerëz, resurse materiale dhe financiar	Mënyra e monitorimit verifikimit/dokumenti	Treguesit e realizimit të prioriteve të ZHPBSH
			Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik			

## Modeli i strukturës së planit individual për zhvillimin profesional (ZHPM)

<b>Emri dhe mbiemri</b>	
<b>Viti Shkollor</b>	
<b>Data</b>	

<b>PJESA 1: REFLEKTIM MBI PRAKTIKËN</b>
Një sukses nga viti i kaluar që dua ta forcoj më tej:
Një sfidë profesionale që dua ta adresoj këtë vit:
Bazuar te nxënësit e mi, cila është fusha/t ku përmirësimi im do të kishte ndikimin më të madh?

<b>PJESA 2: PLANI I VEPRIMIT PËR ZHVILLIM PROFESIONAL</b>				
OBJEKTIVI 1 ( <i>Çfarë dua të përmirësoj/mësoj</i> )	Aktivitetet ( <i>Çfarë do të bëj?</i> )	Afati kohor	Mbështetja dhe burime që do të më duhen	Mënyra e matjes së progresit
<b>Shembull:</b> <i>Të përmirësoj aftësitë e mia në menaxhimin e sjelljeve sfiduese në klasë.</i>	<i>Të marr pjesë në punëtoritë e shkollës. Të vëzhgoj orën e një kolegu me përvojë. Të vëzhgohem nga një kolegë. Të aplikoj dy strategji të reja dhe t'i dokumentoj rezultatet.</i>	<i>Tetor 2025 - Janar 2026</i>	<i>Këshillim nga pedagogu i shkollës. Orar fleksibil për vëzhgime. Mundësi për t'u angazhuar në diskutime profesionale me kolegë.</i>	<i>Zvogëlimi i numrit të incidenteve në klasë. Rritja e angazhimit të nxënësve. Diskutimet pas vëzhgimeve Reflektimet në ditarin profesional.</i>
OBJEKTIVI 2				

## Modeli për planifikimin e sesioneve të punëtorisë/seminareve me bazë në shkollë

**Moduli 1: Mësimdhënia reaguese (Vlerësimi formativ me cikël të shkurtër - shembull i një planit të punëtorisë për një aktivitetit të ZHPMBSH)**

Sesioni	Tema kryesore	Përmbajtja	Koha	Metoda	Rezultatet e pritura
Sesioni 1 <b>Java e dytë e muajit shtator</b>	Hyrje në vlerësimin formativ	Konceptet bazë, dallimi nga vlerësimi përmbledhës, roli i feedback-ut	1 orë	Ligjëratë interaktive, diskutim	Mësuesit kuptojnë bazat e vlerësimit formativ
Sesioni 3 <b>Java e tretë e muajit shtator</b>	Strategjitë e vlerësimit formativ	Pyetje të hapura, teknika të shpejta (karta dalëse, sinjalet me kartela, vetëvlerësimi, pyetje përforcuese)	1.5 orë	Shembuj praktikë, punë në grupe	Përdorimi i teknikave konkrete në klasë
Sesioni 3 <b>Java katër e muajit shtator</b>	Instrumentet e vlerësimit	Rubrika, lista kontrolli, portofolio, pyetjet përforcuese të ndërlidhura me teknikën Tabelat e bardha.	1.5 orë	Punëtori për hartimin e instrumenteve	Hartimi i instrumenteve të thjeshta të vlerësimit
Sesioni 4 <b>Java katër e muajit shtator</b>	Zbatimi praktik	Planifikimi i një ore mësimore me elemente të vlerësimit formativ me cikël të shkurtër	2 orë	Simulim, prezantime nga grupet	Zbatimi praktik në planifikim dhe reflektim

Përgatitja e porfolios nga mësimdhënësit: Tetor - Nëntor

## Plani i hulumtimit në veprim (afatgjatë/bashkëpunues)

Model për programe ose iniciativa më komplekse në nivel klase, shkolle ose grupi profesional, që zhvillohen gjatë një periudhe më të gjatë (8–12 javë) dhe përfshijnë bashkëpunim midis disa mësimdhënësve ose njësisve të shkollës.

### 1. Të dhënat bazë

Emri i mësimdhënësit / ekipit: \_\_\_\_\_

Shkolla: \_\_\_\_\_ Periudha e zbatimit: \_\_\_\_\_

Mentori / Koordinatori: \_\_\_\_\_

Titulli i hulumtimit në veprim: \_\_\_\_\_

### 2. Përshkrimi i kontekstit

(Shkurt përmblihdh kontekstin ku ndodh hulumtimi, lënda, grupi i nxënësve, sfida e vërejtur, burimet në dispozicion, etj.)

### 3. Problemi / Tema e hulumtimit

(Cili është problemi praktik që dëshirojmë të kuptojmë dhe përmirësojmë?)

Shembull: Përfshirja e ulët e nxënësve në mësimin bashkëpunues gjatë orëve të lëndës së Kimisë.

Tema: \_\_\_\_\_

### 4. Pyetja / Pyetjet hulumtuese

(Formulo 1-2 pyetje që udhëheqin procesin.)

Shembull: Si ndikon përdorimi i pyetjeve reflektuese në nxitjen e mendimit kritik te nxënësit?

Pyetja ime kryesore: \_\_\_\_\_

**Qëllimet e hulumtimit:** Çfarë synon të arrish? Cilat janë ndryshimet që pret të shohësh në praktikë?

### 6. Plani i zbatimit (veprimi)

Hapat	Përshkrimi / Aktiviteti	Kush merr pjesë	Afati	Evidenca që do të mblidhet
1	Analiza e situatës fillestare dhe planifikimi i ndërhyrjes			
2	Zbatimi i ndërhyrjes (në klasë ose në grup kolegësh)			
3	Mbledhja e të dhënave (vëzhgime, reflektime, punime nxënësish)			
4	Analiza e përbashkët dhe reflektimi ndërmjet kolegëve			
5	Rishikimi i praktikës dhe përgatitja e raportit përfundimtar			

**7. Burimet dhe mbështetja e nevojshme:** Përfshi kohën, materialet, mentorimin, mbështetjen institucionale.)

### 8. Mbledhja e të dhënave

Vëzhgime nga orët e mësimi

Punime të nxënësve

Reflektime të mësimdhënësve

Fokus-grupe ose diskutime kolegjiale;  Të tjera: \_\_\_\_\_

### 9. Analiza dhe reflektimi

(Si do të analizohen të dhënat dhe kush do të marrë pjesë në procesin e reflektimit?)

Shembull: Analiza përmes takimeve të ekipit të mësimdhënësve çdo dy javë, duke diskutuar ndryshimet e vërejtura te nxënësit dhe praktikat mësimore.

**10. Gjetjet kryesore:** (Cilat janë rezultatet më të rëndësishme nga hulumtimi?)

### 11. Ndryshimet në praktikë / Hapat e ardhshëm

(Çfarë ndryshimesh u sollën në praktikë dhe si do të mbahen në vazhdimësi?)

### 12. Përfshirja e ekipit dhe bashkëpunimi

Emri dhe mbiemri	Roli në hulumtim	Kontributi kryesor	Koment / Reflektim
1.			
2.			

### 13. Forma për reflektim (për çdo anëtar / javë)

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

1. Çfarë provova gjatë kësaj jave?
2. Çfarë funksionoi mirë dhe pse?
3. Çfarë nuk funksionoi dhe pse?
4. Çfarë mësova nga ky proces?
5. Çfarë ndryshimi planifikoj për javën e ardhshme?

### 14. Përmbledhje përfundimtare e reflektimit të grupit

(Plotësohet pas përfundimit të projektit.)

1. Çfarë mësuam si grup nga ky proces?
2. Cilat janë shembujt e praktikave që duam t'i vazhdojmë?
3. Cilat janë sfidat për fazat e ardhshme?
4. Si do ta ndajmë përvojën me kolegët e tjerë?

### Udhëzime praktike!!!

\* Ky plan është menduar për hulumtime bashkëpunuese që zgjasin 8–12 javë dhe përfshijnë disa mësimdhënës.

\* Forma e reflektimit (pika 13) mund të përdoret çdo javë ose pas çdo faze të rëndësishme.

\* Dokumenti final shërben si evidencë zhvillimore për ZHPMBSH dhe mund të prezantohet në takime profesionale të shkollës.

Nënshkrimet

Ekipi i Hulumtimit: \_\_\_\_\_

Mentori / Koordinator: \_\_\_\_\_

**Model i strukturës së raportit përmbledhës nga trajnimet/ punëtoritë për ZHPMBSH**

<b>Informacione bazike</b>		
Titulli i aktivitetit:		
Data:	Kohëzgjatja:	
Vendi / shkolla:		
Fasilituesi/trajneri:		
Numri i Pjesëmarrësve (f; m):		
<b>Përmbajtja dhe objektivat</b>		
Cili ishte objektivi kryesor i këtij aktiviteti?		
Cilat ishin temat kryesore që u trajtuan?		
<b>Rezultatet dhe mësimet e nxjerra</b>		
Cilat ishin rezultatet ose produktet konkrete të këtij aktiviteti? (Çfarë u arrit?)		
Cilat ishin mësimet kryesore të nxjerra që vlejné të ndahen me kolegët e tjerë?		
Cili ishte vlerësimi i përgjithshëm nga pjesëmarrësit?		
<b>Reflektimi mbi procesin</b>		
Çfarë funksionoi mirë gjatë aktivitetit? (Pikat e forta)		
Cilat ishin sfidat ose vështirësitë e hasura dhe si u tejkaluan?		
<b>Rekomandimet për të ardhmen</b>		
Cilat janë rekomandimet për mbështetje të mëtejshme për pjesëmarrësit?		
<b>Shtojcat</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>● Lista e pjesëmarrjes</li> <li>● Agjenda</li> <li>● Fotografi</li> <li>● Tjetër: _____</li> </ul>		

Raporti u përgatit nga: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

## Korniza e përmbajtjes për portofolion profesionale të ZHPMBSH

**Qëllimi:** Portofolio profesionale është një përmbledhje e strukturuar e dëshmive që dokumenton reflektimin, arritjet dhe rritjen tuaj profesionale gjatë një viti shkollor. Ajo shërben si një mjet për vetëvlerësim dhe si dëshmi për angazhimin tuaj në zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Portofolio profesionale mund të përmbajë:

### I. Dokumentet e planifikimit

- **Plani individual i zhvillimit profesional:** Dokumenti kryesor që përcakton objektivat tuaja për vitin (*shih shtojcën në udhëzues*)
- **Filozofia ime e mësimdhënies:** Një deklaratë e shkurtër (opsionale) për parimet tuaja profesionale.

### II. Dëshmitë e pjesëmarrjes dhe zbatimit

- **Certifikata dhe vërtetime:** Për pjesëmarrjen në trajnime, punëtori, etj.
- **Plane mësimore të modifikuara:** Shembuj konkretë të planeve që tregojnë zbatimin e metodave të reja.
- **Materiale mësimore të krijuara:** Çdo material i ri që keni përgatitur (prezantime, fletë pune, etj.).
- **Produkte të punës së nxënësve:** Shembuj anonimë që dëshmojnë ndikimin e praktikave të reja.
- **Fotografi:** Dëshmi vizuale nga zbatimi i metodave të reja, puna në projekte, ose mjedisi i klasës (gjithmonë duke respektuar privatësinë e nxënësve). Çdo fotografi duhet të shoqërohet gjithmonë me një **përshkrim të shkurtër** (diciturë) që shpjegon se çfarë po ndodh në foto dhe si lidhet me aktivitetin e ZHP.

### III. Dokumentet e reflektimit dhe vlerësimit

- **Reflektime të shkruara:** Reflektime të shkurtra për aktivitetet ku keni marrë pjesë ose për zbatimin e një praktike të re.
- **Feedback i marrë:** Një përmbledhje e komenteve konstruktive të marra nga kolegët ose mentori.



Logo e komunës



Logo e shkollës

**CERTIFIKATË E ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE  
ME BAZË NË SHKOLLË**

për znj/z. N.N  
për pjesëmarrje dhe përfundim të suksesshëm të

**PROGRAMIT DHE AKTIVITETEVE TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
ME BAZË NË SHKOLLË TË PLANIFIKUARA PËR VITIN SHKOLLOR  
2025/2026**

N.N.

Drejtoreshë e shkollës

N.N.

Mentori për ZHPMBSH

(Prishtinë, datë \_\_\_\_\_)

Programi dhe aktivitetet e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2025/2026, janë miratuar nga KDSH me datë 30.08.2025.

Programi dhe aktivitetet e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë në të cilat mësimitdhënësi/ja N.N. \_\_\_\_\_ ka qenë i/e përfshirë dhe i ka përmbushur me sukses kërkesat për certifikim, janë pjesë e programit KosEd **Praktika pedagogjike e bazuar në dëshmi.**

Modulet e përfunduara me sukses:

Moduli 1: Mësimitdhënia reaguese ( 6 orë )

Moduli 2: Informata kthyesë efektive dhe vlerësimi ( 6 orë )

Moduli 3: Mësimnxënia e individualizuar ( 6 orë )

Moduli 4: Të nxënit e vetërregulluar ( 6 orë )

Moduli 5: Përfshirja e mësimit aktiv në praktikën pedagogjike ( 6 orë )

Moduli 6: Përfshirja e mësimit bashkëpunues në praktikën pedagogjike ( 6 orë )

Moduli 7: Të nxënit me nxënësin në qendër ( 6 orë )

Moduli 8: Formësimi aktiv i të nxënit nga nxënësit ( 6 orë )

Mësimitdhënësi/ja N.N. \_\_\_\_\_ gjatë kësaj periudhe të zhvillimit profesional me bazë në shkollë, **ka arritur gjithsej 48 orë të zhvillimit profesional**, të cilat mund të dëshmohen në sistemin e licencimit të mësimitdhënësve dhe për qëllime të tjera që lidhen me zhvillimin në karrierë të mësimitdhënësve.

(Prishtinë, \_\_\_\_\_)

## Bibliografia

- Fullan, M. (2001). *Leading in a culture of change*. Jossey-Bass.
- Goddard, J. T., dhe Buleshkaj, O. (2018). Drejt një modeli të ri të integruar dhe të bazuar në shkollë të zhvillimit profesional dhe të karrierës së mësimdhënësve në Kosovë. Konceptdokument i pabotuar dhe i përgatitur për Projektin e Përmirësimit të Sistemit të Arsimit (ESIP). MASHT, Prishtinë, Kosovë.
- Instituti Pedagogjik i Kosovës, (2016), Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë, Prishtinë, <https://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/03/Udhëzuesi-për-zbatim-të-kurrikulës1.pdf>,
- Kaçaniku, F. (2020). Teacher-researcher development? Unpacking the understandings and approaches in initial teacher education in Kosovo. *Center for Educational Policy Studies Journal*, 10(3), 53–76.
- Kaçaniku, F. (2024). Making research relevant for future teachers: fostering a problem-solving research model in initial teacher education. In *enhancing the value of teacher education research*. Brill. [https://doi.org/10.1163/9789004689992\\_012](https://doi.org/10.1163/9789004689992_012)
- Kaçaniku, F. & Aliu, J. (2024). Institucionalizimi i praktikës reflektuese dhe vendimmarrjes së bazuar në dëshmi: Modeli i sigurimit të cilësisë (sc) i udhëhequr nga kolegët si katalizator për transformimin e arsimit në Kosovë (raport).
- KosED. (2022). Praktika pedagogjike e bazuar në dëshmi. <https://www.kosed.org/sq/copy-of-peer-led-evaluation-program>
- KosED. (2022). Rishikimi Bazë i Vlerësimit të Jashtëm. KosED/DAI. Faqja e internetit e KosEd. Modeli Kosovar i Sigurimit të Cilësisë i Udhëhequr nga Kolegët - Lista e dokumenteve: <https://www.kosed.org/sq/copy-of-teacher-recruitment-and-gover-1>
- Mehmeti, S. (2024). Analizë e trendëve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në Kosovë. *Kërkime Pedagogjike*, 4(1), 7–26. <https://doi.org/10.62928/kp.v4i1.4562>
- Mehmeti, S., Zylfiu, H., Potera, I., Buleshkaj, O. & Ulrike Lehner (2016). Manual për sigurim të cilësisë në shkollë. MASHT. Përgatitur me përkrahje të KulturKontakt Austria në kuadër të Projektit të Binjakëzimit.
- Nikoçeviq-Kurti, E., & Saqipi, B. (2022). Toward developing a qualitative mentoring program for pre-service teachers: Kosovo's experience. *Issues in Educational Research*, 32(2), 634-658. <http://www.iier.org.au/iier32/nikoceviq-kurti.pdf>
- Saqipi, B. (2012). Raport mbi vlerësimin e nevojave të mësimdhënësve, zhvillimi profesional për zbatimin e Kornizës së re të kurrikulumit të Kosovës, EU IPA 2009 projekt, Prishtinë.
- Saqipi, B. (2012). Raport mbi vlerësimin e nevojave të mësimdhënësve, zhvillimi profesional për zbatimin e Kornizës së re të kurrikulumit të Kosovës, EU IPA 2009 projekt, Prishtinë.
- Saqipi, B. (2014). Developing teacher professionalism and identity in the midst of large- scale education reform – the case of Kosovo [Doctoral dissertation, University of Jyväskylä]. *Journal of Teacher Researcher* 2/2014, Jyväskylä (Finland): Tuope. ISSN 1238-4631; ISBN 978-952-5066-73-9. <https://minerva.lib.jyu.fi/thesis-search/>

- Saqipi, B. (2014). Developing teacher professionalism and identity in the midst of large- scale education reform – the case of Kosovo [Doctoral dissertation, University of Jyväskylä]. *Journal of Teacher Researcher* 2/2014, Jyväskylä (Finland): Tuope. ISSN 1238-4631; ISBN 978-952-5066-73-9. <https://minerva.lib.jyu.fi/thesis-search/>
- Saqipi, B. (2019). Teacher education policy discourse in the midst of system reorganization and policy transfer: Lessons for small and developing countries. *International Journal of Management in Education*, 13(1), 28-39.
- Saqipi, B. (2020). Using activity systems theory to understand change process in developing teacher as researcher at master level studies. *International Journal of Learning and Change*, 12(1), 1–14.
- Schein, E. H. (2010). *Organizational culture and leadership* (4th ed.). Jossey-Bass.

#### **Dokumente – politika arsimore:**

- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Udhëzimi administrativ nr. 24/2016: Sigurimi i cilësisë në arsimin parauniversitar. MASHT, Prishtinë. MASHT, Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf180.pdf>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2017). Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornizë-strategjike.pdf>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2016). Udhëzimi administrativ për aktivet profesionale (departamentet) të shkollave, Prishtinë, <https://masht.rks-gov.net/udhezimet-administrative-2016>,
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë. IPK, Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles>
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>).
- Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2022). **Udhëzues për zbatim të zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë.**
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2024). Katalogu i programeve të akredituara dhe të aprovuara për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të arsimit në Kosovë - edicioni i shtatë. MASHTI, Prishtinë. <https://masht.rks-gov.net/katalogu-i-programeve-te-aprovuara-perzhvillim-profesional-te-mesimdhenesve-dhepunonjesve-arsimor/>
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2023). Udhëzimi administrativ (UA) 14/2023 për sistemin e licencimit dhe karrierën e mësimdhënësve. <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-14-2023-per-sistemin-e-licencimit-dhe-karrieren-ne-mesimdhenie/>
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2023). Udhëzimi administrativ 15/2023 për vlerësimin e performancës mësimdhënësve. <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-15-2023-per-vleresimin-e-performances-se-mesimdhenesve/>
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. (2023). Udhëzimi administrativ (UA) nr. 16/2023 për zhvillim profesional të mësimdhënësve. <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mashti-nr-16-2023-per-zhvillimin-profesional-te-mesimdhenesve/>